




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South



KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0040771-3/24 dt. 26.06.2024
Mitrovicë

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, alineja d, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); neneve 10 paragrafi 3 nënparagrafi 3.4 dhe 12 paragrafi 5 të Ligjit Nr.08/L-208 Për Parqet Industriale dhe Teknologjike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 24 / 30 Nëntor 2023); nenit 13, paragrafi 1, nënparagrafi 4, të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4 dt. 24.09.2020; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 26.06.2024, nxjerr këtë:

VENDIM

Për caktimin e qirasë për shfrytëzuesit e Parkut Industrial dhe Teknologjik në Mitrovicë

1. CAKTOHET lartësia e qirasë për shfrytëzim të Parkut Industrial dhe Teknologjik në Mitrovicë
2. Sipas pikës një (1) të këtij vendimi Operatorët Ekonomik të vendosur në Parkun Industrial dhe Teknologjik paguajnë qira vjetore në shumën prej 0.05 € për M² me TVSH.
3. Qiraja do të inkasohet nga Komuna e Mitrovicës së Jugut si Administrues i Parkut Industrial dhe Teknologjik dhe do të përdoret për qëllim të mbulimit të kostos së funksionimit të mirëfilltë dhe mirëmbajtjes së parkut dhe sigurimit të të hyrave të arsyeshme për menaxhimin e parkut;
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria për ekonomi, zhvillim, turizëm dhe integritet evropian dhe Drejtoria për buxhet dhe financa.
5. Vendimi shpallet pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë



Kryesuesja e Kuvendit

Vesa BROJA
Vesa BROJA

Dorëzohet:

1 x 1 Kryesueses së Kuvendit

1 x 1 MAPL

1 x 1 Arkivit

Kopje: Kryetarit të Komunës

Drejtorisë për ekonomi, zhvillim, turizëm dhe integritet evropian

Drejtorisë për Buxhet dhe Financa